



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e neneve 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Rekomandimit të Drejtorit të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim të datës 19.05.2025 si si dhe Kërkesës Urgjente të Menaxherit të N.J.O Lipjan KRM "Pastrimi" për furnizim me derivate Nr. 13-352/01-24758 të datës 19.05.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.05.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FURNIZIMIN E PËRKOHSHËM ME DERIVATE TË AUTOMJETEVE TË NJËSISË OPERATIVE "KRM" PASTRIMI NË LIPJAN

- I. **TË FURNIZOHEN**, përkohësisht me derivate automjetet e Njësië Operative KRM "Pastrimi" në Lipjan të cilat operojnë me grumbullimin e mbeturinave sipas planit të tyre operativ në territorin e Komunës së Lipjanit për shkak të gjendjes së rëndë financiare që gjendet aktualisht kjo Ndërmarrje publike rajonale , aksionare e së cilës është edhe Komuna e Lipjanit duke u bazuar edhe në Rekomandimin e Drejtorit të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim të datës 19.05.2025 si dhe Kërkesën Urgjente të Menaxherit të N.J.O Lipjan KRM "Pastrimi" për furnizim me derivate Nr. 13-352/01-24758 të datës 19.05.2025.
- II. Furnizimi me derivate siq ceket në pikën I të këtij Vendimi është i natyrës urgjente dhe ka qëllim parësor mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të komunës i cili mund të rrezikohet seriozisht nga mbeturinat e mbetura nëpër kontinjerë të amvisërive familjare, bizneseve, objekteve të institucioneve publike dhe jopublike dhe në ambientet tjera.
- III. Njësia operative në Lipjan për secilin furnizim të automjetit me derivate duhet ta plotësoj kërkesën përkatëse e cila duhet të aprovohet paraprakisht nga Menaxheri mbikqyrës i cili do të caktohet me Vendim të Kryetarit të Komunës dhe pas furnizmit faturat ti dorëzoj te Menaxheri i njëjtë Mbikqyrës.
- IV. Furnizimi me derivate do të bëhet vetëm në pompën e derivateve me të cilën Komuna e Lipjanit ka kontratë për furnizim .

V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Drejtorati për Administratë, Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

VI. Ky Vendim është i përkohshëm dhe vlen vetëm 1 (një) muaj nga dita e hyrjes në fuqi dhe pas kësaj periode nuk prodhon më asnjë efekt juridik.

VII. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-352/01-27010
Lipjan, më 29.05. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

